

**VENDIM**  
**“Mbi kërkesën për heqjen e sekuestros konservative”**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë prej:

**GJYQTARE Teuta HOXHA**

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Adela Çinari, në Tiranë, datë 07.04.2017 mori në shqyrtim kërkesën penale me Nr. **1492/144** Akti që u përket:

**KËRKUES:** Personit nën hetim **A. E. D., atësia E. amësi M., dtl 27.03.19.., në Itali dhe banues në Tarzo, provincë e Treviso-s, arësim i lartë juridik, profesion agjent immobilar, i martuar me tre fëmijë shtetësi dhe kombësi Italiane i padënuar, mbrojtur nga Demir Çiftja.**

**Objekti** Heqje e masës së sigurimit pasuror të sekuestros mbi llogaritë bankare të bankës Intesa San Paolo Bank në emër të A. D.

**Baza ligjore** Neni 274 i K.Pr.Penale;

Gjykata, zhvilloi seancën gjyqësore në prani të mbrojtësit të kërkuesit që kërkoi pranimin e kërkesës ; dëgjoi prokurorin që kërkoi rrëzimin e kërkesës ; dhe si shqyrtoi në tërësi aktet;

**V Ë R E N**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi kërkesën e prokurorisë me objekt vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj personit A. E. D. për kryerjen e veprës penale “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, me vendimin Nr.519 akti datë 26.02.2016 ka vendosur:

“Vleftësimin të ligjshëm të ndalimit të personit nën hetim A. E. D..

Caktimin e masës së sigurimit personal “Arrest në Burg” parashikuar nga neni 238 i K.Pr. Penale.

Urdhërohet Policia Gjyqësore të zbatojë menjëherë vendimin e mësipërm në përputhje me procedurat ligjore”.

Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr.519 akti datë 26.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga aktet ka rezultuar se shtetasi i huaj A. E. D. që nga data 28.07.2015 është bërë klient Bankës Intesa SanPaolo Bank me poshtë (ISP) në Tiranë dhe ka deklaruar se është agjent tregtar. Më datë 10.08.2015 ai ka depozituar në bankë tre çeqe për clering 45 ditë me vlerë totale 115.000 EUR, të lëshuara nga Banca Agricola Commerciale (BAC) e San Marinos në

emër të A. D.. (këto çeqe pas mbarimit, të afatit 45 dite dhe procesit të verifikimit me bankën lëshuese BAC, janë bërë të vlefshme në llogarinë personale të A. D. në datë 13.10.2015)

Gjithashtu, me datë 01.10.2015 kërkuesi A. D. ka depozituar edhe 11 çeqe të tjerë për klering 45 ditë, me vlerë totale 524.000 EURO (të cilat bëhen të vlefshme në llogari në dt 04.12.2015 pas verifikimit me bankën lëshuese (BAC). Më datë 16.10.2015 ka tërhequr 50.000 EUR dhe qëllimi i tërheqjes deklarohet për biznes.

Kështu A. D. disponon pranë Bankës ISP 65.000 EUR (cash) si dhe 524.000 EUR vlere çeqesh në llogarinë e tij personale .

Nga veprimet hetimore ka rezultuar se kërkuesi ka bere nje njoftim prane bankes per te terhequr shumen prej 50.000 Euro me date 13.11.2015. Per kete terheqje ai ka arsyetuar se do te likujdoje faturat e leshuara nga shoqeria "A...", te cilat jane fatura te formatit te thjeshte dhe jo fatura tatimore me vlere 39.400 Euro.

Nga hetimet e kryera ka rezultuar se personi nën hetim për të justifikuar burimin e të ardhurave dhe arsëyen e tërheqjes së tyre nga Banka ISP ka depozituar në Bankë një faturë blerje të disa pajisjeve dentare nga shoqëria "A..." si dhe faturën e shitjes së tyre nga Kompleksi Spitalo Universitar "...".

Për verifikimin e këtyre faturave, policia gjyqësore ka pyetur shtetasin A. M., administrator i shoqërisë A..., i cili ka pranuar se ka njohje me personin nën hetim dhe ka mohuar të ketë kryer shitje blerje të pajisjeve që përmban fatura e sekuestruar me logon e kësaj shoqërie si dhe mohon të jetë lëshuar faturë me logon e A...it në favor të të dyshuarit.

Në kushtet e mësipërme, policia gjyqësore ka vepruar me iniciativë dhe ka ndaluar personin nën hetim, ndalim i cili është vlerësuar si i ligjshëm nga gjykata sipas vendimit nr.519 akti datë datë 26.02.2016.

Gjithashtu nga ana e organit procedues është vendosur masa e sekuestros konservative në shumat e gjendura në llogari.

Përkatësisht me vendimin e datës 15.02.2016 prokurori ka vendosur sekuestrimin e shumave që rezultojnë në emër të paditësit pranë Intesa San Paolo Bank Sha.

Me kërkesën e paraqitur kërkuesi ka kërkuar heqjen e masës së sekuestros konservative në llogaritë e tij duke parashtruar se nga ana e prokurorisë është dërguar për gjykim vetëm lidhur me akuzën e "Falsifikimi i dokumentave" dhe për asnjë akuzë tjetër, pasi nuk është gjetur nga prokuroria ndonjë lidhje me veprën penale "Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Në kërkesën e paraqitur dhe në shpjegimet e dhëna kërkuesi ka parashtruar se nga aktet e marra në formë shkresore nga Prokuroria e Trevizos Itali dhe Deshmia e Penalitetit e lëshuar nga Ministria Italiane e Drejtësisë vërtetohet se kërkuesi nuk është i dënuar për kyerjen e ndonjë vepre penale. Ai ka pretenduar se shumat e depozituara në llogarinë bankare kanë kaluar nëpërmjet bankës dhe kanë si burim të krijimit të tyre aktivitetin e tij dhe të ardhurat

e familjes . Në mbështetje të kërkesës së tij, kërkuesi ka paraqitur dëshminë e penaltetit si dhe disa akte shkresore që konfirmojnë prona të paluajtshme në emër të tij.

Në shpjegimet e dhëna në gjykim prokurori ka referuar se kërkuesi A. D. ndodhet për gjykim vetëm për veprën penale të “Falsifikimit të dokumentave” parashikuar nga neni 186 i K.Penal dhe procedimi është ndarë lidhur me veprën penale “Pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale” për të cilën vazhdojnë hetimet pa autor. Prokurori ka shpjeguar se nga përgjigja e një letërporosie ka rezultuar se bashkëshortja e kërkuesit ka një dekret penal për mospagim të kontributeve shoqërore, dhe ndërsa është dërguar edhe një letërporosi e dytë e cila është ende pa përgjigje dhe çështja ndodhet nën hetim.

Neni 274 i K.Pr. Penale parashikon : *“Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.*

*2.Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal. 3*

*3.Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.”*

Ndërsa në neni 210 të K.Pr.Penale parashikohet se një vendim i tillë në rastet e ngutshme mund të merret nga prokurori.

Gjykata çmon se paraqitja e dokumentit të dëshmisë së penaltetit lidhur me gjendjen gjyqësore të kërkuesit apo bashkëshortes së tij nuk përbën rrethanë për ndryshimin e kushteve të zbatimit të masës së sekuestros. Po ashtu provat e tjera të paraqitura nga kërkuesi pranë prokurorit dhe që ndodhen të administruara edhe në këtë gjykim janë të pamjaftueshme për të konkluduar se nuk ekzistojnë kushtet e zbatimit të masës sekuestros në tërësi.

Nga ana tjetër, organi i akuzës vijon hetimin për veprën penale “Pastrimii të produkteve të veprës penale” dhe për këtë pritet edhe përgjigja e një letërporosie të dytë drejtuar autoriteteve italiane. Në këto kushte për sa kohë që vazhdon hetimi për elementë të veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale” është e pakuptimtë heqja e sekuestros konservative mbi shumat e bllokuara, pasi në eventualitet të zbulimit të autorit, nuk do të garantohej plotësisht dhe me të gjithë elementët e nevojshëm ekzekutimi i vendimit penal.

Bazuar në sa më lart, gjykata konkludon në rrëzimin e kërkesës.

## **PËR KËTO ARËSYE**

Bazuar në nenet 260 të K. Pr. Penale, Gjykata;

## **V E N D O S I**

**I. Rrëzimin e kërkesës.**

**II.** Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 10 ditëve.

- **U shpall në Tiranë më 07.04.2017.**

**SEKRETARE**

**Adela Çinari**

**GJYQTARE**

**Teuta HOXHA**